



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.104/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Vera Gashi Bala, në çështjen përmbarimore të kreditorit “RamaPrint” – K.R. B.I., Rahovec, me numër të biznesit 810397217, kundër debitorit Lëvizja Vetëvendosje – Qendra Rahovec, me numër fiskal 600659364, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.536/22 të datës 27.12.2022, të Përmbaruesit Privat Irfan Kërçagu, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 29.12.2023 merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Lëvizja Vetëvendosje – Qendra Rahovec, ANULOHET Urdhri Përmbarimor P.nr.536/22, i datës 16.09.2022 i lëshuar nga Përmbaruesi Privat Irfan Kërçagu dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbarimi në këtë çështje përmbarimore.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me datë 27.12.2022 ka lëshuar Urdhrin përmbarimor P.nr.536/22, me të cilin ka caktuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm - faturës nr.125/19 e datës 11.10.2019, me të cilin detyrohet debitori që në emër të përmbushjes së obligimeve nga dokumenti i besueshëm i lartcekur, brenda afatit 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrin, t’ia paguan kreditorit shumën prej 747.50 € me kamatë ligjore prej 8% nga data e kalimit të afatit për pagesë e deri në përmbushje definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi.

Debitori, në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor duke theksuar se fatura për pagesën e borxhit të pretenduar është faturë e lëshuar njëanshëm nga ana e kreditorit. Palët nuk kanë pasur ndonjë raport civilo juridik, marrëveshje apo kontratë për kryerjen e shërbimeve për reklama dhe vizitkartela. Me tej thekson se i mungon legjitimiteti pasiv, sepse i njëjti nuk e ka autorizuar pranuesin e faturës që të veprojë në emër të debitorit, andaj edhe pretendon se kreditori duhet ti drejtohet personit fizik me të cilin kreditori eventualisht mund të ketë pasur dakordim verbal për kryerjen e këtyre shërbimeve. Së fundi ka theksuar se kërkesa për pagesën e borxhit është parashkruar në kuptim të nenit 355 par.1 të

LMD-së. Andaj, Gjykatës i ka propozuar të anulohet urdhri përmbartimor dhe të abrogohen të gjitha veprimet përmbartimore lidhur me ekzekutimin e urdhrit përmbartimor P.nr.536/22.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të parashtruar brenda afatit ligjor, i ka kundërshtuar pretendimet e debitorit si të pabazuara, me arsyetim se personi i cili i ka porositur mallin dhe e ka pranuar faturën është person zyrtarë i selisë Qendra në Rahovec, i cili vepron në emër dhe për llogari të kësaj partie, është person i njohur për opinion publik dhe është struktura më e lartë në këtë parti, dhe udhëheqës i Qendrës në Rahovec. Gjithashtu, ka kundërshtuar pretendimet lidhur me parashkrimin e kërkesës me arsyetim se kreditori përmbartimin e ka kërkuar brenda afatit të bazuar në nenin 352 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve. Gjykatës i ka propozuar të refuzohet në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbartimor.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar për shkaqet si në vijim:

Gjykata, vlerësoj pretendimin e debitorit lidhur me parashkrimin e kërkesave të kreditorit dhe gjeti se fatura lëndore është lëshuar me datë 11.10.2019, kurse propozimi për përmbartim lidhur me këtë faturë është paraqitur me datë 27.12.2022. Andaj, konform nenit 355 par 1 të LMD-së i cili përcakton se “ *Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite*”, dhe paragrafin 2 të të njëjtit nen me të cilin përcaktohet se: “*Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer*”, Gjykata erdhi në përfundim se kërkesa që buron nga kjo faturë ka arritur afatin e parashkrimit, pasi që nga koha e lëshimit të saj me datë 11.10.2019 e deri në paraqitjen e propozimit me datë 27.12.2022 kanë kaluar mbi tri vite.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se prapësimi i debitorit është i bazuar konform nenit 71, par.1, nën-par. 1.10 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore i cili përcakton se: “*1. Sipas nenit 69 të këtij ligji, prapësimi mund të bazohet vetëm nëse: 1.10. kërkesa nga dokumenti përmbartues është e mbrojtur me ndonjë statut të kufizimeve*” dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundohet në tërësi.

Gjykata vendimin për përfundimin e procedurës përmbartimore e mori konform nenit 66, par.3 të LPP-së, i cili përcakton se: “*Përmbartimi do të përfundohet edhe kur ai është bërë i*

pamundshëm apo kur nga shkaqe të tjera nuk mund të zbatohet, si dhe pas kalimit të afatit absolut të parashkrimit për përmbarim”.

Gjykata, pati parasysh pretendimin e kreditorit se në rastin konkret kërkesa është parashtruar konform nenit 352 të LMD-së, por që të njëjtin pretendim e vlerësoj si të pabazuar për faktin se afati i caktuar me nenin 352 gjen zbatim në rastet kur me ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër, ndërsa siç edhe është elaboruar më lart në rastin konkret vlen afati i përcaktuar me dispozitat ligjore nga neni 355 i LMD-së.

Nga sa u tha më lart, Gjykata konform nenit 66, 71 par. 1.10, 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.104/23, datë 29.12.2023

Gjyqtarja

Vera Gashi Bala

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.